



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA /
AGENCY OF GENDER EQUALITY



Raporti i Hulumtimit Ndërgjeneracional SIT 2025



Opinione publike mbi temat gjinore:
Stereotipet gjinore, dhuna me bazë gjinore dhe barazia gjinore

SIT – QENDRA PËR KËSHILLIM,
SHËRBYME SOCIALE DHE HULUMTIME
TETOR 2025

Prishtinë

Ky raport është realizuar me mbështetjen e Zyrës së Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsi në Kosovë (UNFPA). Përmbajtja mbetet përgjegjësi e plotë e SIT – Qendrës për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e UNFPA-së apo të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

Hulumtuese: Elma Berisha

SIT – Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime
Tetor 2025

Prishtinë

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	6
PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE	9
KUPTIMI I DHUNËS ME BAZË GJINORE	10
ROLI GJINOR & STEREOTIPET	16
QËNDRIMET NDAJ DHUNËS NË FAMILJE & NGACMIMIT SEKSUAL	23
QËNDRIMET NDAJ BARAZISË GJINORE	29
PËRFUNDIME & MËSIMET KRYESORE	34
SHTOJCË: PËRMBLEDHJE E MOSTRËS	38

Hyrje

Në qershor të vitit 2025, SIT, në bashkëpunim me UNFPA, realizoi një anketë për të mbledhur perspektiva si nga të rinjtë, ashtu edhe nga të moshuarit, lidhur me barazinë gjinore, qëndrimet ndaj roleve dhe stereotipeve gjinore, si dhe kuptimet mbi dhunën me bazë gjinore. Studimi përdori një qasje ndërgjeneracionale, duke krahasuar përgjigjet mes katër grupmoshave: Gjenerata Z (18-29 vjeç), Gjenerata Y ose "Milenialët" (30-45 vjeç), Gjenerata X (46-60 vjeç) dhe "Bumerat" - (Gjenerata e lindur afërsisht ndërmjet viteve 1946-1964) (60+ vjeç).

Ky hulumtim bazohet në një studim të mëparshëm të SIT-it, "Dhuna me bazë gjinore përmes këndvështrimit të gjeneratës Z" (2024), i cili ishte fokusuar ekskluzivisht tek të anketuarit meshkuj nga Gjenerata Z. Studimi aktual e zgjeron këtë fushë duke përfshirë edhe të anketuarat femra dhe duke krahasuar gjetjet mes gjeneratave të ndryshme. Kjo qasje më e gjerë është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e transformimeve të vazhdueshme shoqërore në Kosovë si shoqëri post-konfliktuale të karakterizuara nga migrimi rural-urban, tranzicioni drejt një ekonomie të tregut të lirë, ndryshimet kulturore të ndikuara nga globalizimi, si dhe lidhjet e forta me diasporën dinamike.

Qëllimi kryesor i këtij studimi është të shqyrtojë qëndrimet e publikut në Kosovë ndaj roleve gjinore, stereotipeve gjinore, dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje, ngacmimit seksual dhe barazisë gjinore. Gjetjet synojnë të forcojnë përpjekjet e shoqërisë civile dhe institucioneve për të ndërtuar strategji më efektive në parandalimin dhe eliminimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore.

Metodologjia e Hulumtimit


Raporti bazohet në një anketë sasiore, e cila u lansua dhe u monitorua përmes platformës Qualtrics. Në total, fillimisht u plotësuan 344 anketa duke përdorur një version të përkthyer në shqip të pyetësorit, i cili ishte testuar paraprakisht para lansimit zyrtar. Grumbullimi i të dhënave u zhvillua ndërmjet 9 qershorit dhe 5 shtatorit 2025, me 80% të mostrës së synuar të përfunduar gjatë muajit gusht.

Gjatë procesit të kontrollit të cilësisë, 30 anketa u përjashtuan për shkak të përgjigjeve të pamjaftueshme në të katër temat kryesore; 8 u hoqën për mungesë përgjigjesh në tre temat e fundit dhe 1 u përjashtua për shkak të mungesës së të dhënave demografike. Analiza përfundimtare bazohet në 305 anketa të përfunduara, me një kohëzgjatje mesatare prej 6.88 minutash për anketë.


Mostra u siguria duke përdorur një qasje të kombinuar: vetë-plotësim online për të anketuarit më të rinj dhe anketa ballë për ballë të asistuar me tablet për disa nga pjesëmarrësit më të moshuar. Objektivat e mostrës u përcaktuan duke përdorur një tabelë trefishe krahasuese sipas moshës, gjinisë dhe zonës së banimit. Të gjitha objektivat e mostrës u arritën, përveç dy grupeve: meshkujt e moshës 45-60 vjeç në zonat urbane dhe meshkujt mbi 60 vjeç në zonat rurale.

Mostra përfundimtare (N=305) është përfaqësuese dhe statistikisht e mjaftueshme në kategoritë kryesore demografike: gjinia (meshkuj kundrejtë femra), mosha (18-28, 29-44, 45-60, 60+) dhe zona e banimit (urbane kundrejtë rurale). Rezultatet për kategorinë mbi 60 vjeç duhet të interpretohen me kujdes.


SHPËRNDARJA E MOSTRËS SIPAS MOSHËS/GJINISË



SHPËRNDARJA E MOSTRËS SIPAS MOSHËS/ZONËS SË BANIMIT



SHPËRNDARJA E MOSTRËS SIPAS GJINISË/ZONË SË BANIMIT



Përmbledhje e gjetjeve kryesore

Rezultatet nga mostra e përgjithshme (N=305), pa dalluar sipas kategorive demografike, tregojnë kryesisht se dhuna ende shpeshherë kuptohet përmes formave të sulmeve fizike, frikës, përdorimit të forcës dhe kërcënimeve. Një pjesë më e vogël e të anketuarve e identifikuan dhunën në formën e kontrollit shoqëror nga bashkëshorti/bashkëshortja/partneri/partnerja, qoftë në sjellje apo në qasje ndaj informacionit.

Shumica e të anketuarve hodhën poshtë rolet tradicionale gjinore dhe stereotipet. Megjithatë, stereotipi i burrit si figura kryesore e familjes vazhdon të jetë i pranishëm, me 40% të të anketuarve që e mbështesin këtë pikëpamje.

Shumica e të anketuarve shprehën kundërshtim ndaj dhunës me bazë gjinore. Më shumë se 90% nuk u pajtuan me deklaratën se një grua duhet të durojë dhunën në familje për të ruajtur familjen. Megjithatë, prirja për të justifikuar kryerësin e dhunës dhe për t'ia vënë fajin viktimës mbetet e pranishme.

Inkurajues është fakti se një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve refuzuan mohimet më të zakonshme të barazisë gjinore. Megjithatë, një pakicë e dukshme ende mban qëndrime që e minojnë barazinë.

Gjeneratat më të reja shfaqin qëndrime më progresive, ndërsa grupmoshat më të vjetra (45-60 dhe 60+) mbajnë më shumë qëndrime stereotipike. Të anketuarat femra në mënyrë të qëndrueshme shfaqin qëndrime dhe pikëpamje më progresive. Popullata urbane në përgjithësi tregon nivel më të lartë të vetëdijes dhe kuptimit për çështjet gjinore.

Është inkurajues fakti se tek të anketuarit e moshës 18-28, dallimet janë minimale si sipas gjinisë ashtu edhe sipas zonës së banimit. Ky model përsëritet në shumicën e matjeve të anketës, duke sugjeruar se gjenerata më e re (18-28) ka qëndrime relativisht të unifikuara ndaj dhunës me bazë gjinore, pavarësisht prejardhjes demografike. Në kontrast, dallime më të mëdha vërehen përgjithësisht tek gjeneratat më të vjetra, veçanërisht sipas gjinisë dhe vendbanimit.

Megjithëse ekziston një mbështetje e gjerë për barazinë gjinore dhe një kundërshtim i hapur ndaj dhunës me bazë gjinore, një pakicë e konsiderueshme ende justifikon stereotipet, kontrollin shoqëror dhe format më delikate të dhunës me bazë gjinore. Për t'i adresuar këto sfida, nevojiten ndërhyrje të synuara dhe të ndjeshme ndaj kontekstit, të cilat sfidojnë normat e rrënjosura dhe forcojnë barazinë gjinore si themel i një shoqërie të lirë dhe progresive. Integrimi i barazisë gjinore në arsim, angazhimi komunitar dhe kornizat politike do të jetë thelbësore për të arritur ndryshime të qëndrueshme.

Kuptimi i dhunës me bazë gjinore

Sipas UNHCR-së, dhuna me bazë gjinore (DhBGj) përkufizohet si “një term-ombrellë që përfshin çdo akt të dëmshëm të kryer kundër vullnetit të një personi dhe që bazohet në dallimet gjinore të përcaktuara nga shoqëria (dmth. gjinore) midis meshkujve dhe femrave. Kjo përfshin akte që shkaktojnë dëm ose vuajtje fizike, seksuale apo mendore, kërcënime për akte të tilla, detyrim dhe forma të tjera të privimit nga liria. Këto akte mund të ndodhin si në hapësira publike, ashtu edhe private.”¹


Ky studim testoi disa parametra sjelljeje, ku të gjitha lidhen me dhunën me bazë gjinore. Të anketuarve iu bë pyetja: “Cilat nga sjelljet e mëposhtme konsiderohen si dhunë? Duke përdorur një shkallë nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë ‘Asnjëherë dhunë’ dhe 4 do të thotë ‘Gjithmonë dhunë’, ju lutemi vlerësoni mendimin tuaj nëse një sjellje e tillë përbën dhunë apo jo.” Në këtë seksion, një rezultat më i lartë tregon një kuptim më të mirë të aspekteve të dhunës me bazë gjinore.

Rezultatet nga mostra e përgjithshme (N=305), pa dalluar sipas kategorive demografike, tregojnë kryesisht se dhuna ende shpeshherë njihet si sulme fizike, frikë, përdorim force, dhe kërcënime. Një pjesë më e vogël e të anketuarve e identifikuan dhunën në formën e kontrollit nga bashkëshorti/ bashkëshortja apo partneri/partnerja, qoftë në sjellje apo në qasje ndaj informacionit. Rreth një e treta e të anketuarve justifikuan mbikëqyrjen e vazhdueshme të qasjes në informacion nga ana e burrit (32%) ose gruas (36%), ndërsa pothuajse një e katërta (24%) justifikuan kontrollin shoqëror të ushtruar nga burri mbi bashkëshorten e tij. Fatkeqësisht, 21% e mostrës së përgjithshme treguan prirje për të justifikuar dhunën ekonomike.


Në një aspekt më pozitiv, mbi 80% e të anketuarve e njohën presionin psikologjik (“Një burrë kritikon vazhdimisht një grua për ta bërë të ndihet keq apo e pavlerë”) si dhunë me bazë gjinore. Në mënyrë të ngjashme, 86% e identifikuan sjelljen agresive fizike të burrit (“Një burrë hedh ose thyen sende për të frikësuar apo kërcënuar një grua”) si dhunë, edhe nëse nuk shkaktohet dëm i drejtpërdrejtë fizik. Megjithatë, mbetet shqetësuese që 20% e të anketuarve ende mbajnë qëndrime stereotipike, duke besuar se një burrë tipik ka gjasa ose pritet të ushtrorë kontroll brenda familjes apo rrethit të ngushtë, dhe mund të përdorë mjete të dhunshme kur e konsideron të nevojshme.

¹ Politika e UNHCR-së mbi Parandalimin, Zbutjen e Rrezikut dhe Reagimin ndaj Dhunës me Bazë Gjinore, 2020, UNHCR


BURRI HEDH APO THYEN OBJEKTET PËR TA FRIKËSUAR APO KËRCËNUAR GRUAN




BURRI E KRITIKON GRUAN VAZHDIMISHT QË TA BËJË TË NDIHET KEQ APO E PADOBISHME




BURRAT JANË BURRA: PRITET PREJ TYRE TË USHTROJNË KONTROLL QOFTË EDHE ME FORCË




BURRI KONTROLLON PARATË E GRUAS PËRKUNDËR VULLNETIT TËSAJ




BURRI E KONTROLLON JETËN SHOOËRORE TË GRUAS DUKE IA NDALUAR TË TAKOHEN ME FAMILJE DHE SHOQËRI



BURRI INSISTON TË JETË I INFORMUAR PËR LËVIZJET/VENDODHJEN E GRUAS PËRGJATË GJITHË KOHËS




GRUAJA INSISTON TË JETË E INFORMUAR
PËR LËVIZJET/VENDODHJEN E BURRIT
PËRGJATË GJITHË KOHËS




Këto gjetje ndryshojnë sipas kategorive të ndryshme të mostrës, siç paraqitet më poshtë. Duke filluar me sjelljen që njihet më qartë si dhunë nga mostra e përgjithshme (86% e të anketuarve, N=305) "Një burrë hedh ose thyen sende për të frikësuar apo kërcënuar një grua" analiza tregon dallimet më të mëdha tek të anketuarit mbi 60 vjeç, veçanërisht ndërmjet zonave rurale dhe urbane.


Gratë dhe burrat në zonat rurale të kësaj grupmoshe kishin më pak gjasa ta identifikonin këtë sjellje si dhunë. Një hendek i ngjashëm vërehet midis burrave ruralë dhe grave urbane të moshës 29-44 vjeç. Vlen të theksohet se dallimi ndërmjet grupmoshës 29-44 dhe asaj 45-60 vjeç është statistikiisht domethënës në këtë drejtim.




Burrat urbanë të moshës 45-60 vjeç dhe mbi 60 vjeç e pranuan unanimitisht sjelljen “Një burrë kritikon vazhdimisht një grua për ta bërë të ndihet keq apo e pavlerë” si dhunë (rezultati mesatar 4/4), ndërsa burrat urbanë të grupmoshës 29-44 vjeç mbetën dukshëm prapa (rezultati mesatar 2.5/4).




Dallime statistikisht domethënëse shfaqen ndërmjet të anketuarve meshkuj të moshës 18–28 vjeç dhe atyre 45–60 vjeç, ku grupmosha më e vjetër kishte më shumë gjasa ta identifikojë sjelljen “Burrat janë burra: pritet që ata të ushtrojnë kontroll detyrues” si dhunë. Ndër të anketuarit meshkuj urbanë, hendeuku midis moshës 29–44 vjeç dhe 45–60 vjeç është edhe më i theksuar.




Të anketuarit në zona urbane shfaqën rezultate dukshëm më të mira në njohjen e formave ekonomike të dhunës me bazë gjinore, si p.sh. “Një burrë kontrollon paratë e gruas së tij kundër vullnetit të saj.” Të anketuarit më të rinj (18-28 vjeç) po ashtu patën rezultate më të larta, veçanërisht krahasuar me të anketuarit në zonat rurale të grupmoshës 45-60 vjeç dhe mbi 60 vjeç.




Në identifikimin e kontrollit shoqëror “Një burrë kontrollon jetën shoqërore të një gruaje duke e penguar atë të takojë familjen dhe miqtë” të anketuarit meshkuj, nëpër shumicën e gjeneratave dhe zonave të banimit, shënuan rezultate të dobëta. Hendeku gjinor është më i dukshmi tek mosha 29–44 vjeç, ku të anketuarat femra shënuan dukshëm më lartë.



Të anketuarit në zonat urbane shfaqën njohje dukshëm më të mirë të sjelljeve kontrolluese, konkretisht “Një burrë këmbëngul të dijë gjithmonë vendndodhjen e gruas së tij” dhe “Një grua këmbëngul të dijë gjithmonë vendndodhjen e burrit të saj.”



Në të dy rastet, hendeku urban-rural është më i theksuar tek gjenerata 45–60 vjeç.



Rolet dhe Stereotipet Gjinore

Duke pasur parasysh që stereotipet gjinore janë të pranishme në të gjitha shoqëritë dhe evoluojnë me kalimin e kohës dhe rrethanave, ky studim synoi të vlerësonte trendet e përgjithshme në nivel të përgjithshëm, duke shqyrtuar gjithashtu ndryshimet në perceptime dhe të qëndrime në të gjitha kategoritë e mostrës. U testua një gamë e gjerë rolesh dhe stereotipesh gjinore, me disa deklaratat të formuluarat qëllimisht për të sfiduar supozimet. Të anketuarve iu bë pyetja: “Duke përdorur një shkallë nga 1 deri në 4, ku 1 do të thotë ‘Nuk pajtohem aspak’ dhe 4 do të thotë ‘Pajtohem plotësisht’, ju lutemi tregoni nivelin tuaj të pajtueshmërisë me secilën deklaratë.” Është e rëndësishme të theksohet se në këtë seksion, një rezultat më i lartë nuk tregon domosdoshmërisht një përgjigje më të favorshme, pasi interpretimi varet nga përmbajtja specifike e secilës deklaratë.

Gjetjet nga mostra e përgjithshme (N=305), pa dalluar sipas kategorive, tregojnë se shumica e të anketuarve refuzuan rolet tradicionale dhe stereotipet gjinore. Për shembull, 86% nuk u pajtuan me idenë se burrat janë logjikisht superiorë, dhe 83% nuk u pajtuan me mendimin se burrat janë më të përshtatshëm për shkencë dhe teknologji. Është inkurajues fakti se 87% e të anketuarve u pajtuan se vajzat kanë po aq nevojë për shkollim sa djemtë, duke theksuar rëndësinë e arsimit për të dy gjinitë. Vetëm gjysma e të anketuarve (52%) u pajtuan me deklaratën se gratë duhet të jenë më të arsimuara sesa burrat, për shkak se ato mbajnë përgjegjësinë për edukimin e fëmijëve. Nga ata që nuk u pajtuan, disa komentuan se qëndrimi i tyre bazohet në mbështetjen për barazinë gjinore në rolet familjare.

Megjithatë, disa stereotipe mbeten ende të përhapura. Pothuajse një e treta (31%) e të anketuarve mbështetën bindjen se roli më i rëndësishëm i një vajze është martesë dhe krijimi i familjes (“Është më e rëndësishme që vajzat të martohen dhe të krijojnë familje”). Po ashtu, 30% u pajtuan me idenë se gratë fitojnë më pak sepse punojnë më pak, duke e barazuar me gjasë “punën” vetëm me punësimin e paguar. Stereotipi i burrave si udhëheqës të familjes gjithashtu vazhdoi të jetë i pranishëm, me 40% të të anketuarve që e mbështesin këtë pikëpamje. Këto gjetje ndryshojnë sipas kategorive të mostrës, siç do të diskutohet në seksionet në vijim.

Stereotipet Gjinore

■ Mospajtohem (1 & 2)

■ Pajtohem (3&4)




Në përgjithësi, gjinia duket të jetë një faktor i rëndësishëm në shumicën e stereotipeve gjinore të testuara në këtë studim, me të anketuarat femra që, mesatarisht, shfaqin mendim më pak stereotipik.

Megjithatë, për disa deklaratë, nuk vërehen dallime domethënëse ndërmjet burrave dhe grave. Si të anketuarit meshkuj, ashtu edhe femrat, u pajtuan fuqimisht se "Vajzat kanë po aq nevojë për shkollim sa djemtë", dhe shprehën mospajtim të fortë me deklaratën "Të jemi realistë, punët në shkencë (STEM/ShTIM - (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë) janë për burra, jo për gra dhe vajza." Në të njëjtën mënyrë, nuk pati dallime domethënëse gjinore në përgjigjet ndaj deklaratës "Gratë edukojnë fëmijët, prandaj ato duhet të jenë më të arsimuara se burrat."


Në një nivel më të detajuar, shfaqen disa përjashtime. Për shembull, gratë urbane të grupmoshës 45-60 vjeç treguan nivele më të larta paragjykimi në disa matje.

Për sa i përket variacionit urban-rural, dallimet në shumicën e stereotipeve gjinore janë statistikiisht domethënëse. Të anketuarit urbanë, kishin pikëpamje më pak stereotipike lidhur me rolet gjinore krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre në zonat rurale.


Pajtueshmëria me deklaratën "Burrat janë më të aftë se gratë në të menduarit logjik" ishte përgjithësisht e ulët, veçanërisht tek të anketuarat femra të moshës 18-28 dhe 29-44 vjeç, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale. Nuk u gjetën dallime statistikiisht domethënëse sipas grupmoshës apo zonës së banimit.




Pajtuueshmëria me deklaratën “T’jemi të drejtë, punët në shkencë (STEM/ShTIM - (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë) janë për burra, jo për gra dhe vajza” ishte gjithashtu përgjithësisht e ulët, përveçse tek të anketuarit ruralë mbi 60 vjeç. Nuk u shfaqën dallime statistikisht domethënëse ndërmjet kategorive.




Stereotipi i “gruas emocionale” vazhdoi të jetë i pranishëm tek të anketuarat femra rurale mbi 60 vjeç.




Stereotipi i “burrave si udhëheqës të komunitetit” shfaqet më pak i përhapur tek gjeneratat më të reja krahasuar me ata mbi 60 vjeç. Interesant është fakti se të anketuarit meshkuj të moshës 18-28 vjeç u pajtuan më shumë me këtë pikëpamje sesa bashkëmoshataret e tyre femra. Të anketuarit mbi 60 vjeç shënuan nivelet më të larta në këtë stereotip, me dallime ndërgjeneracionale që rezultuan statistikisht domethënëse.




Bindja se “Gratë punojnë më pak se burrat, prandaj fitojnë më pak para” mbështetej më shpesh nga të anketuarit në zonat rurale, veçanërisht nga gratë rurale të moshës 60 vjeç e lart.




Të anketuarit meshkuj, në përgjithësi, kishin më shumë gjasa sesa të anketuarat femra të pajtohen me deklaratën “Është më e rëndësishme që vajzat të martohen dhe të krijojnë familje.” Përfundim përbënë gratë rurale mbi 60 vjeç, të cilat shënuan rezultate të ngjashme me burrat.




Edhe pse të anketuarit meshkuj dhe femra të moshës 18-28 vjeç ishin përgjithësisht afër në përgjigjet e tyre, të rinjtë meshkuj shprehën një pajtueshmëri më të lartë me deklaratën “Burrat, dhe jo gratë, duhet të marrin kontrollin e marrëdhënieve dhe të jenë kryefamiljarë.” Në përgjithësi, të anketuarit e moshës 45-60 vjeç shënuan nivele më të larta në këtë stereotip krahasuar me gjeneratat më të reja (18-28 dhe 29-44 vjeç).



Deklarata provokuese “Gratë edukojnë fëmijët, prandaj ato duhet të jenë më të arsimuara se burrat” i ndau të anketuarit në dy grupe. Përgjigjet sugjerojnë se arsimi ende lidhet fuqishëm me punën dhe të ardhurat materiale, më shumë sesa në kuptimin më të gjerë të dijes dhe ndriçimit.



Deklarata me pajtueshmërinë më të lartë nga të gjithë të anketuarit ishte “Vajzat kanë po aq nevojë për shkollim sa djemtë.” Dallimet ndërmjet grupeve ishin minimale, megjithatë burrat ruralë të moshës 18-28 vjeç rezultuan pak më ulët se të tjerët.



Qëndrimet ndaj dhunës në familje dhe ngacmimit seksual

Bota nuk është një vend i sigurtë për gratë, dhe stereotipet gjinore së bashku me tendencat kulturore për ta minimizuar dhe normalizuar dhunën luajnë një rol në ruajtjen e këtij realiteti. Në këtë studim, disa role dhe stereotipe gjinore u testuan, me disa deklaratatë të formuluar qëllimisht në mënyrë të kundërt. Të anketuarve iu kërkua të vlerësonin pajtueshmërinë e tyre në një shkallë prej katër pikësh, ku 1 nënkuptonte “Aspak dakord” dhe 4 nënkuptonte “Plotësisht dakord.” Ashtu si në seksionin e mëparshëm, rezultatet më të larta nuk nënkuptojnë automatikisht përgjigje më të favorshme, pasi interpretimi varet nga përmbajtja e secilës deklaratë.


Gjetjet nga mostra e përgjithshme (N=305), pa dalluar sipas kategorive, tregojnë se shumica e të anketuarve kundërshtuan dhunën me bazë gjinore. Mbi 90% nuk u pajtuan me deklaratën se një grua duhet të durojë dhunën në familje për të ruajtur unitetin familjar (“Një grua duhet të tolerojë dhunën për ta mbajtur familjen së bashku”), dhe 93% u pajtuan me deklaratën se “Shoqëria duhet të veprojë në unitet kundër të gjitha formave të dhunës ndaj grave, në shtëpi apo jashtë saj.”

Megjithatë, një pakicë shqetësuese (7-9%) shfaqën qëndrime që e justifikojnë ose e minimizojnë dhunën. Dymbëdhjetë përqind e të anketuarve besojnë se është më mirë që një grua të mos e raportojë dhunën në familje nëse kjo do të sillte shpërbërjen e familjes (“Një grua duhet të raportojë dhunën në familje edhe nëse kjo nënkupton shpërbërjen e familjes”). Pothuajse një e katërta (24%) u pajtuan me deklaratën se “Dhuna në familje është një çështje private që duhet të trajtohet brenda familjes.” Prirja për të justifikuar kryerësin e dhunës dhe për të fajësuar viktimën është më e dukshme në deklaratën “Në rastet e dhunës në familje, fajin e kanë të dy bashkëshortët,” e cila u mbështet nga 45% e të anketuarve.


Dhuna me Baze Gjinore dhe Ngacmimet Seksuale

■ Mospajtohem (1 & 2)


■ Pajtohem (3&4)




Pajtuueshmëria me deklaratën “Një grua duhet të tolerojë dhunën për ta mbajtur familjen së bashku” ishte përgjithësisht shumë e ulët, përveçse tek të anketuarit ruralë mbi 60 vjeç.




Pajtueshmëria me deklaratën “Dhuna në familje është një çështje private që duhet të trajtohet brenda familjes” ishte gjithashtu e ulët, me përjashtim të grave rurale të moshës 45-60 vjeç.




Të anketuarit shfaqën një pajtueshmëri të lartë me deklaratën “Një grua duhet të raportojë dhunën në familje edhe nëse kjo nënkupton shpërbërjen e familjes,” përveçse tek gratë rurale të moshës 45-60 vjeç dhe të anketuarit urbanë të grupmoshës 29-44 vjeç.




Përgjigjet ndaj deklaratës “Në rastet e dhunës në familje, fajin e kanë të dy bashkëshortët” ishin shumë të ndryshme. Hendeku ishte i theksuar midis burrave urbanë dhe atyre ruralë të moshës 45-60 vjeç, dhe po ashtu i dukshëm midis grave urbane dhe rurale të grupmoshës 29-44 vjeç.




Përgjigjet ndaj pyetjes “Burrat sillen dhunshëm në shtëpi sepse e dinë se një shoqëri patriarkale e lejon këtë” kërkojnë interpretim të kujdesshëm. Deklarata u kuptua ndryshe nga të anketuarit: disa nuk ishin dakord, duke nënkuptuar “Shoqëria jonë nuk e lejon më këtë”, ndërsa të tjerë ranë dakorod për të shprehur kritika ndaj normave patriarkale që e mundësojnë dhunën. Për shkak të këtyre interpretimeve të përziera, rezultatet duhen lexuar me kujdes.




Të anketuarit meshkuj të moshës 18-28 dhe mbi 60 vjeç kishin më shumë gjasa të pajtoheshin me deklaratën “Gratë dhe vajzat përjetojnë ngacmim sepse janë të veshura në mënyrë provokuese”, si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale.



Pati një pajtueshmëri të lartë me deklaratën “Qeveria duhet të zbatojë dënime për kryerësit e dhunës online me bazë gjinore (Facebook, TikTok, etj.)”. Të anketuarit meshkuj të moshës 45-60 vjeç shfaqën pajtueshmëri më të fortë krahasuar me ata të moshës 29-44 vjeç.



Pati një pajtueshmëri të gjerë me deklaratën “Shoqëria duhet të veprojë në unitet kundër të gjitha formave të dhunës ndaj grave, në shtëpi apo jashtë saj”, megjithatë të anketuarit ruralë mbi 60 vjeç rezultuan pak më mbrapa.




Qëndrimet ndaj barazisë gjinore

Në këtë studim u testuan disa elemente që matin qëndrimet e të anketuarve ndaj barazisë gjinore, me disa deklarata të formuluara qëllimisht në mënyrë të kundërt. Të anketuarve iu kërkua të tregonin nivelin e pajtueshmërisë së tyre në një shkallë prej katër pikësh, ku 1 korrespondonte me “Aspak dakord” dhe 4 me “Plotësisht dakord”. Ashtu si në seksionin e mëparshëm, një rezultat më i lartë nuk nënkupton domosdoshmërisht një përgjigje më të favorshme, pasi interpretimi varet nga përmbajtja e secilës deklarate.


Është inkurajues fakti se një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve refuzuan arsyetimet më të zakonshme që nënvlerësojnë barazinë gjinore. Konkretisht, 72% nuk u pajtuan me nocionin se barazia gjinore është një mit, 79% nuk u pajtuan me idenë se ajo krijon më shumë probleme sesa zgjidh, dhe 87% hodhën poshtë mendimin se grave po u “jepen shumë të drejta”.

Megjithatë, një pakicë e dukshme ende mban qëndrime që minojnë barazinë. Më shumë se një e katërta (28%) e të anketuarve u pajtuan me deklaratën “Barazia gjinore është një mit: gratë dhe burrat kurrë nuk mund të jenë të barabartë sepse janë të ndryshëm”. Poashtu, 21% mbështetën idenë se “Barazia gjinore krijon më shumë probleme sesa zgjidh”, dhe 13% besuan se “Grave nuk duhet t’u jepen shumë të drejta, pasi ato priren t’i keqpërdorin”.


Këto gjetje përforcohen edhe më tej nga qëndrime më të gjera ndaj progresit shoqëror. Një e katërta (25%) e mostrës nuk u pajtua me idenë se një shoqëri e lirë dhe progresive duhet të sigurojë barazi për të gjithë, 19% nuk u pajtuan se barazia gjinore është rruga e vetme përpara, dhe 12% hodhën poshtë të drejtat e barabarta të trashëgimisë për vajzat dhe djemtë. Të marra së bashku, këto rezultate sugjerojnë se, ndonëse ekziston një mbështetje e fortë për barazinë gjinore, rreth një e pesta e popullsisë vazhdon t’i vë në dyshim ose t’i kundërshtojë parimet e saj.




Pajtuueshmëria me deklaratën “Grave nuk duhet t’u jepen shumë të drejta, pasi ato priren t’i keqpërdorin” ishte përgjithësisht e ulët. Në zonat rurale, u vërejtën disa dallime gjinore tek gjeneratat më të vjetra, por nuk u gjetën dallime statistikisht domethënëse ndërmjet kategorive kryesore.




Pajtueshmëria me idenë se “Barazia gjinore krijon më shumë probleme sesa zgjidh” ishte gjithashtu e ulët në përgjithësi si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale. Gratë rurale të moshës 60 vjeç e lart dalloheshin për mbështetje më të lartë.




Pajtueshmëria me deklaratën “Barazia gjinore është një mit: gratë dhe burrat kurrë nuk mund të jenë të barabartë sepse janë të ndryshëm” ishte përgjithësisht e ulët si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale. Përsëri, gratë rurale mbi 60 vjeç treguan një mbështetje më të lartë krahasuar me grupet tjera.




Avokimi për barazinë gjinore dhe kundërshtimi i patriarkatit variuan nga mesatarja deri tek e ulëta, veçanërisht tek burrat ruralë të moshës 29-44, 45-60 dhe mbi 60 vjeç. Në të kundërt, gratë rurale të grupmoshave 18-28, 29-44 dhe 45-60 shënuan po aq lartë sa gratë urbane në pajtueshmërinë me deklaratën “Unë vazhdimisht kundërshtoj praktikat patriarkale”.




Pajtueshmëria me deklaratën “Një shoqëri që nuk arrin të sigurojë barazi për të gjithë anëtarët e saj, nuk e meriton lirinë” ishte nga mesatare në të lartë, në të dyja zonat urbane dhe rurale. Gratë urbane të të gjitha gjeneratave u veçuan për një mbështetje të fortë.



Pajtueshmëria me deklaratën “Barazia gjinore është e vetmja rrugë përpara për të siguruar një shoqëri progresive” në përgjithësi ishte e lartë, në të gjitha kategoritë. Të anketuarit meshkuj nga zonat urbane të moshës 18-28 vjeç u veçuan për një mbështetje disi më të ulët.



Pajtueshmëria me deklaratën “Vajzat duhet të kenë të njëjtën të drejtë për trashëgimi si djemtë” ishte e lartë në përgjithësi, si tek të anketuarit urbanë ashtu edhe tek ata ruralë. Të anketuarit meshkuj të moshës 18-28 vjeç treguan një mbështetje më të ulët krahasuar me grupet e tjera.



Përfundime dhe mësim kryesor

Kuptimi i dhunës me bazë gjinore:

- Rezultatet nga mostra e përgjithshme (N=305), pa dalluar sipas kategorive demografike, tregojnë kryesisht se dhuna ende shpeshherë njihet përmes sulmeve fizike, frikës, përdorimit të forcës dhe kërcënimeve. Një pjesë më e vogël e të anketuarve e identifikuan dhunën në terma të kontrollit bashkëshortor ose të partnerit/es, qoftë në sjelle apo në informacion. Megjithatë, një përqindje e madhe e të anketuarve e njohën presionin psikologjik si dhunë me bazë gjinore (80%) dhe identifikuan sjelljet agresive fizike të burrit si dhunë, edhe nëse nuk shkatohet dëm i drejtpërdrejtë fizik (86%).
- Është shqetësuese që 20% e të anketuarve ende mbajnë qëndrime stereotipike, duke besuar se një burrë “tipik” ka gjasa ose pritet të ushtrojë kontroll brenda familjes apo rrethit të ngushtë, dhe mund t’u drejtohet mjeteve të dhunshme kur e sheh të nevojshme. Rreth një e treta e të anketuarve justifikuan mbikëqyrjen e vazhdueshme informative nga burrat (32%) ose gratë (36%), ndërsa pothuajse një e katërta (24%) justifikuan kontrollin shoqëror të ushtruar nga burri ndaj bashkëshortes së tij. Fatkeqësisht, 21% e mostrës së përgjithshme treguan prirje për të justifikuar dhunën ekonomike.
- Të anketuarat femra të të gjitha brezave janë më të mira në njohjen e dhunës me bazë gjinore, krahasuar me meshkujt. Gratë ruale mbi 60 vjeç shpesh mbetën prapa.
- Të anketuarit urbanë nga të gjitha gjeneratat treguan aftësi më të madhe për të njohur dhunën me bazë gjinore, krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre ruralë. Ndërgjegjësimi i tyre për aspektet e kontrollit ekonomik dhe mbikëqyrjes është dukshëm më i lartë.
- Ka dallime ndërmjet kategorive të moshës lidhur me atë që ata e konsiderojnë si dhunë me bazë gjinore. Dallimet janë statistikisht domethënëse ($p < 0.05$) vetëm në tre raste:
 - Gjenerata 45-60 rezultoi më mirë se 29-44: “Një burrë hedh ose thyen sende për të frikësuar apo kërcënuar një grua”.
 - Gjenerata 45-60 rezultoi më mirë se 18-29: “Burrat janë burra: pritet që ata të ushtrojnë kontroll detyrues”.
 - Gjenerata 45-60 rezultoi më dobët se 18-29: “Burri kontrollon paratë e gruas pavarësisht vullnetit të saj”.

Mbështetja e roleve dhe stereotipeve gjinore:

- Gjetjet nga mostra e përgjithshme (N=305), pa dalluar sipas kategorive, tregojnë se shumica e të anketuarve refuzuan rolet dhe stereotipet tradicionale gjinore. Për shembull, 86% nuk u pajtuan me idenë se burrat janë më superiorë në mënyrën e të menduarit logjik, dhe 83% nuk u pajtuan me idenë se burrat janë më të përshtatshëm për shkencë dhe teknologji. Është inkurajues fakti se 87% e të anketuarve u pajtuan se vajzat kanë po aq nevojë për arsimim sa djemtë, duke theksuar rëndësinë e edukimit për të dy gjinitë.
- Megjithatë, disa stereotipe mbeten ende të përhapura. Stereotipi i burrave si udhëheqës të familjes vazhdoi të jetë i pranishëm, me 40% të të anketuarve që e mbështetën këtë mendim. Pothuajse një e treta (31%) e të anketuarve mbështetën bindjen se roli më i rëndësishëm i një vajze është martesë dhe krijimi i familjes; ndërsa 30% u pajtuan me idenë se gratë fitojnë më pak sepse punojnë më pak, duke e barazuar "punën" vetëm me punësimin e paguar.
- Në përgjithësi, të anketuarit meshkuj shënuan rezultate më të larta në mbështetjen e stereotipeve gjinore, krahasuar me femrat. Diferenca është statistikisht domethënëse ($p < 0.01$), përveçse në tre raste:
 - "Vajzat kanë po aq nevojë për shkollim sa djemtë".
 - "Gratë edukojnë fëmijët, prandaj duhet të jenë më të arsimuara sesa burrat".
 - "T'jemi të drejtë, punët në shkencë (STEM/ShTIM - (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë) janë për burra, jo për gra dhe vajza."
- Në përgjithësi, të anketuarit ruralë shënuan rezultate më të larta në mbështetjen e stereotipeve gjinore, krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre urbanë. Dallimet janë statistikisht domethënëse ($p < 0.01$), përveçse në katër raste:
 - "Vajzat kanë po aq nevojë për shkollim sa djemtë."
 - "Burrat janë më të aftë se gratë në të menduarit logjik."
 - "Gratë edukojnë fëmijët, prandaj duhet të jenë më të arsimuara sesa burrat."
 - "T'jemi të drejtë, punët në shkencë (STEM/ShTIM - (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë) janë për burra, jo për gra dhe vajza."
- Gjithashtu ka dallime ndërmjet kategorive të moshës sa i përket stereotipeve gjinore, me mbështetje më të lartë të stereotipeve tek gjeneratat 45–60 dhe mbi 60, krahasuar me 18–28 dhe 29–44. Diferenca është statistikisht domethënëse ($p < 0.05$), përveçse në rastet e mëposhtme, ku ndryshimet ndërmjet gjeneratave janë minimale:
 - "Gratë janë tepër emocionale për të qenë udhëheqëse të mira."
 - "Vajzat kanë po aq nevojë për shkollim sa djemtë."
 - "Burrat janë më të aftë se gratë në të menduarit logjik."
 - "T'jemi të drejtë, punët në shkencë (STEM/ShTIM - (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë) janë për burra, jo për gra dhe vajza."

Attitudes towards Domestic Violence & Sexual Harassment:

- Gjetjet nga mostra e përgjithshme (N=305), pa dalluar sipas kategorive, tregojnë se shumica e të anketuarve ishin kundër dhunës me bazë gjinore. Mbi 90% nuk u pajtuan me deklaratën se një grua duhet të durojë dhunën në familje për të ruajtur familjen.
- Megjithatë, një pakicë shqetësuese (7–9%) shfaqën qëndrime që e justifikojnë ose e minimizojnë dhunën.

Dymbëdhjetë përqind e të anketuarve besuan se është më mirë që një grua të mos e raportojë dhunën në familje nëse kjo do të çonte në shpërbërjen e familjes. Pothuajse një e katërta (24%) e panë dhunën në familje si “një çështje private që duhet trajtuar brenda familjes.” Prirja drejt justifikimit të kryerësit të dhunës dhe fajësimit të viktimës është ende e pranishme.

- Në përgjithësi, nuk pati dallime domethënëse sa i përket dhunës në familje ndërmjet të anketuarve meshkuj dhe femra, përveçse në dy raste. Së pari, të anketuarit meshkuj shënuan dukshëm më lart ($p < 0.01$) për deklaratën “Një grua duhet të tolerojë dhunën për ta mbajtur familjen së bashku.” Po ashtu, të anketuarit meshkuj u pajtuan më shumë me deklaratën “Gratë dhe vajzat përjetojnë ngacmim sepse janë të veshura në mënyrë provokuese.”
- Në përgjithësi, nuk pati dallime domethënëse sa i përket dhunës në familje ndërmjet të anketuarve urbanë dhe ruralë, përveçse për deklaratën “Një grua duhet të tolerojë dhunën për ta mbajtur familjen së bashku.” Në këtë rast, të anketuarit ruralë shfaqën një pajtueshmëri dukshëm më të lartë.
- Ekzistojnë dallime ndërmjet kategorive të moshës sa i përket dhunës në familje, me pajtueshmëri më të lartë tek gjeneratat 45-60 dhe mbi 60, krahasuar me 18-28 dhe 29-44. Diferenca është statistikisht domethënëse ($p < 0.05$) vetëm në disa raste. Gjenerata mbi 60 priret të pajtohet më shumë me idenë se ngacmimi seksual lidhet me veshjen provokuese. Gjenerata 18-28 shënoi dukshëm më ulët krahasuar me të gjitha gjeneratat e tjera për deklaratën “Një grua duhet të tolerojë dhunën për ta mbajtur familjen së bashku.”

Qëndrimet ndaj barazisë gjinore:

- Është inkurajues fakti se një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve hodhën poshtë arsyetimet më të zakonshme që nënvlerësojnë barazinë gjinore. Konkretisht, 72% nuk u pajtuan me nocionin se barazia gjinore është një mit, 79% nuk u pajtuan me idenë se ajo krijon më shumë probleme sesa zgjidh, dhe 87% refuzuan mendimin se grave po u “jepen shumë të drejta.”
- Megjithatë, për fat të keq, një pakicë e dukshme ende mban qëndrime që e minojnë barazinë. Më shumë se një e katërta (28%) e të anketuarve u pajtuan me deklaratën “Barazia gjinore është një mit: gratë dhe burrat kurrë nuk mund të jenë të barabartë sepse janë të ndryshëm.” Po ashtu, 21% mbështetën mendimin se “Barazia gjinore krijon më shumë probleme sesa zgjidh,” dhe 13% besuan se “Grave nuk duhet t’u jepen shumë të drejta, pasi ato priren t’i keqpërdorin.”
- Këto gjetje përforcohen edhe nga qëndrime më të gjera ndaj përparimit shoqëror. Një e katërta (25%) e mostrës nuk u pajtua me idenë se një shoqëri e lirë dhe progresive duhet të sigurojë barazi për të gjithë, 19% nuk u pajtua se barazia gjinore është rruga e vetme përpara, dhe 12% hodhën poshtë të drejtat e barabarta të trashëgimisë për vajzat dhe djemtë. Të marra së bashku, këto rezultate sugjerojnë se, ndonëse ekziston një mbështetje e fortë për barazinë gjinore, afërsisht një e pesta e popullsisë ende vazhdojnë ta vënë në dyshim ose t’i kundërshtojnë parimet e saj.
- Në përgjithësi, nuk pati dallime domethënëse sa i përket barazisë gjinore ndërmjet të anketuarve meshkuj dhe femra, përveçse në tre raste. Të anketuarat femra shënuan dukshëm më lartë në temat:
 - “Barazia gjinore është e vetmja mënyrë për të siguruar një shoqëri progresive.”
 - “Unë vazhdimisht kundërshtoj praktikën patriarkale.”
 - “Vajzat duhet të kenë të njëjtën të drejtë për trashëgimi si djemtë.”
- Në përgjithësi, nuk pati dallime domethënëse sa i përket barazisë gjinore ndërmjet të anketuarve urbanë dhe ruralë, përveçse për deklaratën “Unë vazhdimisht kundërshtoj praktikën patriarkale.” Në këtë rast, të

anketuarit urbanë treguan një pajtueshmëri dukshëm më të lartë.

- Ekzistuan më pak dallime ndërmjet kategorive të moshës në lidhje me barazinë gjinore, krahasuar me temat e mëparshme. Ndërsa, gjenerata 45–60 shënoi dukshëm më ulët se të gjitha gjeneratat e tjera për deklaratën “Unë vazhdimisht kundërshtoj praktikat patriarkale.”

Mësimet kryesore

1. Forcimi i ndërgjegjësimit për dhunën jo-fizike

- Zgjeroni fushatat e edukimit publik për të theksuar se dhuna me bazë gjinore përfshin presionin psikologjik, kontrollin ekonomik dhe mbikëqyrjen, jo vetëm dëmtimin fizik.
- Nevojiten programe të përshtatura për zonat rurale dhe gjeneratat më të vjetra, ku njohja e këtyre formave të dhunës mbetet më e ulët.

2. Sfidë stereotipet gjinore të qëndrueshme

- Promovoni narrativa mbi udhëheqjen e përbashkët në familje dhe kompetencën e barabartë profesionale, për të kundërshtuar besimin se burrat janë “udhëheqës natyralë”.
- Zhvilloni kurrikula dhe përmbajtje mediatike që kundërshtojnë rolet tradicionale, si kufizimi i grave vetëm në martesë ose në rolin e kujdestareve.
- Përfshini burrat dhe djemtë drejtpërdrejt në programet për barazinë gjinore, pasi ata tregojnë një nivel më të lartë mbështetjeje për stereotipet sesa gratë.
- Angazhoni gjeneratat më të vjetra në dialog ndërgjeneracional, për të reduktuar përcjelljen e stereotipeve.

3. Adresoni tolerimin dhe justifikimin e dhunës në familje


- Dizajnoni fushata gjithëpërfshirëse dhe iniciativa komunitare që e sfidojnë drejtpërdrejt fajësimin e viktimës dhe idenë se dhuna në familje është një ‘çështje private’.
- Zhvilloni programe shkollore dhe rinore për të forcuar refuzimin e këtyre qëndrimeve të dëmshme tek gjeneratat e reja, duke konsoliduar kundërshtimin e tyre më të fortë ndaj dhunës.

4. Promovoni barazinë gjinore si një vlerë shoqërore


- Forconi mesazhin se barazia gjinore nuk është një mit dhe as burim problemesh, por një element thelbësor për përparimin shoqëror.
- Shfaqni përfitimet shoqërore dhe ekonomike të barazisë për të kundërshtuar bindjen se ajo krijon probleme ose u jep grave “tepër të drejta.”
- Theksoni të drejtat e trashëgimisë dhe të pronësisë në fushatat e ndërgjegjësimit, pasi rezistenca ndaj të drejtave të barabarta mbetet e dukshme.
- Inkurajoni si burrat ashtu edhe gratë që të sfidojnë praktikën patriarkale, duke vendosur popullsinë urbane si aleatë të mundshëm dhe modele për ndryshimin më të gjerë shoqëror.

Shtojcë: Përmbledhje e mostrës


Periudha e Anketës, 2025 (N=305)




Qyteti i të anketuarve (N=305)




Kategoria e moshës / Gjenerata (N=305)




Gjinia (N=305)




Zona aktuale e banimit (N=305)




Zona e banimit të fëmijërisë (N=305)



Zonë banimi (N=305)



Niveli i edukimit (N=305)



	Kategoria e moshës / Gjenerata				Gjinia		Zona e vendbanimit		Total
Niveli i Edukimit	18-28	29-44	45-60	60 +	Male	Female	Urban	Rural	
Pa shkollë	0	0	0	2	1	1	0	2	2
Shkolla fillore	3	0	16	7	16	10	6	20	26
Shkolla e mesme	28	13	35	9	45	40	38	47	85
Certifikatë/Diplomë	17	11	2	2	17	15	18	14	32
Bachelor/Fakultet	73	42	8	7	42	88	91	39	130
Magjistër/Doktoraturë	11	12	6	1	8	22	24	6	30
Total	132	78	67	28	129	176	177	128	305

